

**VENDIM**  
**Nr. 308, datë 29.4.2026**

**PËR KALIMIN E FONDIT PËR T’U PËRDORUR NË FORMËN E KAPITALIT  
FILLESTAR PËR SHOQËRINË “ALBANIAN DIGITAL SOLUTION” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 23, pika 1, e 24, pika 1/1, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin e fondit, në masën 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, për t’u përdorur në formën e kapitalit fillestar për shoqërinë “*Albanian Digital Solution*” sh.a., me NIPT: M61615021U.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi përballohet nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për vitin 2026, në zërin “Shpenzime kapitale”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe shoqëria “*Albanian Digital Solution*” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Albana Koçiu**